

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Edmond Islamaj	Kryesues
Arjana Fullani	Anëtare
Shkëlzen Selimi	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Tom Ndreca	Anëtar

në seancë gjyqësore të datës 20.11.2013, mori në shqyrtim çështjen penale nr.00314-2011 akti, që i përket:

KËRKUES:	PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA TIRANË
TË PANDEHUR:	LAVER TOZAJ, HASAN GJINAJ, HELIDON XHAFERI, ARDI XHAFERI.

**A K U Z U A R:**

Për kryerjen e veprës penale të  
"Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim".  
Baza ligjore: Neni 283/a/2 i K.Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë me vendimin nr.26, datë 21.07.2010, ka vendosur:

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Helidon Xhaferi për kryerje të veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal, sepse nuk provohet kryerja prej tij e kësaj veprë penale, konform pikës "d" të nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në germën "a" të pikës 1 të nenit 261 të Kodit të Procedurës Penale, konstatimin të shuar të masës së sigurimit "arrest në burg", caktuar ndaj të pandehurit Helidon Xhaferi me vendimin nr.135, datë 04.07.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ardi Xhaferi për kryerje të veprës penale të: "Trafikimit të narkotikëve", kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me dhjetë vjet burgim;

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Ardi Xhaferi me gjashtë vjet e tetë muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Hasan Gjinaj për kryerje të veprës penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me njëmbëdhjetë vjet burgim;

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Hasan Gjinaj me shtatë vjet e katër muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të bëhet ne një burg të sigurisë së zakonshme.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhafer, ndryshe Laver Tozaj, për kryerje të veprës penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me dhjetë vjet burgim;

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Xhafer ndryshe Laver Tozaj me shtatë vjet e katër muaj burgim.

Vuajtja e dënimit për këtë të pandehur fillon nga dita e arrestimit të tij dhe të bëhet ne një burg të sigurisë së zakonshme.

Në lidhje me provat materiale CD-të që janë bashkëngjitur këtij gjykimi me cilësinë e provës materiale, gjykata vendos që ato të lihen në ruajtje dhe të vazhdojnë të jenë bashkëngjitur fashikullit të këtij gjykimi, derisa ky vendim gjyqësor të marrë formë të prerë.

Shpenzimet gjyqësore të bëra gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit u ngarkohen solidarisht të pandehurve të cilët janë deklaruar fajtor në këtë vendim.

Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.05, datë 18.01.2011, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.26, date 21.07.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë për të pandehurin Helidon Xhaferi.

Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm për cilësimin ligjor, deklarin fajtor të të pandehurve Ardi Xhaferi, Hasan Gjinaj dhe Xhafer ndryshe Laver Tozaj, për kryerjen e veprës penale “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Ndryshimin e vendimit nr.26, datë 21.07.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda, Tiranë për të pandehurin Ardi Xhaferi për kryerjen e penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Ardi Xhaferi me 4 vjet e 8 muaj burgim.

Në korrigjim të gabimit material për të pandehurin Xhafer (Laver) Zotaj, në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Xhafer (Laver) Zotaj me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Lënien në fuqi të vendimet për pjesët e tjera.

Kundër këtij vendimi, ka ushtruar rekurs Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në pjesën ku është deklaruar i pafajshëm i pandehuri Helidon Xhaferi si dhe përsa i përket deklarin fajtor të të pandehurit Xhafer Tozaj për veprën penale të “Trafikimit të narkotikeve kryer në bashkëpunim” parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal, duke kërkuar dënimin e tij me 12 vjet burg, për këto shkaqe:

- i Është kërkuar ndryshimi i vendimit nr.26 datë 21.07.2010 i Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit Ardi Xhaferi për veprën penale të trafikimit të narkotikëve të kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal dhe dënimi i tij me 13 vjet burg, pasi e konsiderojmë dukshëm të pabazuar aplikimin e nenit 23 për këtë të pandehur, kur dihet se sasia e lëndës narkotike ka qenë dukshëm e madhe.
- i Në të njëjtat kushte është kërkuar ndryshimi i vendimit nr.26 datë 21.07.2010 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për të pandehurin Hasan Gjinaj, duke e deklaruar fajtor për veprën penale të “Trafikimit të narkotikeve” në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal dhe dënimin e tij me 14 (katërbëdhjetë) vjet burgim, për këto shkaqe;
- i Gjykata ka gabuar në parashtrimin e provave dhe interpretimi i bërë nga ana e saj është në kundërshtim me nenin 152/2 të K.Pr.Penale, pasi një provë e rëndësishme që gjykata duhej ta kishte trajtuar me objektivitet, në funksion të provimit të akuzës në ngarkim të të pandehurit Helidon Xhaferi janë thëniet e dëshmitarit Fatos Peqini në lidhje me faktin penal për të cilin akuzohet i pandehuri.
- i Provë tjetër janë dhe thëniet e dëshmitarit Islam Beshku të cilat përputhen plotësisht me ato të Fatos Peqinit dhe me gjithë provat e tjera të këtij gjykimi dhe që nuk janë vlerësuar nga gjykata .
- i Një prove tjetër (indirekte) ose indicje që çojnë në vërtetimin e faktit, që arsyeton gjykata në ngarkim të të pandehurit Helidon Xhaferri janë dhe “tabulatet telefonike por, vlerësimi i tyre i bërë nga gjykata nuk vjen në respektim të neni 152/2 të K.Pr.Penale, pasi nuk është e vërtetë se këto indicje nuk lidhen me prova të tjera.
- i Në vlerësimin tonë, gjykata padrejtësisht ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës nga 283/a/2 të Kodit Penal në nenin 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal, duke e trajtuar rastin si vepër e mbetur në tentativë, kur nga të pandehurit janë kryer të gjitha veprimet dhe vepra nuk mund të konsiderohet si e mbetur në tentativë.
- i Veç sa sipër i konsiderojmë dukshëm subjektive e të gabuara vendimet e të dy gjykatave në pjesën kur kanë aplikuar vendime të buta ndaj të pandehurve, dënime të cilat nuk janë të harmonizuara me rrezikshmërinë e veprës penale dhe të autorëve, për më tepër që sasia e lëndës narkotike ka qenë veçanërisht e madhe dhe e kanë vendosur në një hambar të përgatitur enkas, brenda makinës me tonazh të madh, duke treguar se zotërojnë njohuri për veprime të një natyrë të veçantë.

Kundër vendimit të Gjykatës se Apelit për Krime të Rënda, ka ushtruar rekurs i gjykuari Hasan Gjinaj, nëpërmjet avokatit të tij, i cili kërkon prishjen e këtij vendimi, duke parashtruar këto shkaqe:

- i Jemi përpara rastit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale pasi i pandehuri Hasan Gjinaj është deklaruar fajtor për të njëjtën vepër me vendimin e formës së prerë nr.44 datë 20.09.2007, vepër për të cilën është dënuar fajtor i pandehuri Hasan Gjinaj dhe nuk është kryer asnjë vepër tjetër pas dhënies së vendimit nr.44, datë 20/09/2007.
- i Në vendimin e sipërcituar arsyetohet se procesverbali i deklarimeve të Et’hem Danaj, ku është implikuar i pandehuri Hasan Gjinaj për episodin e datës 17/03.2005 nuk gjen mbështetje në provat e tjera (për këtë arsye nuk është përfshirë në atë vendim ky episod), ndërsa në vendimin nr.5, datë 18.01.2011 që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, prandaj dhe ne e rekursojmë arsyetohet e kundërta dhe prandaj e deklarim fajtor, pra dënohet dy herë për të njëjtën vepër.
- i Në këtë gjykim vendimi i të cilit ankimohet nuk është paraqitur asnjë provë e re veç atyre që ndodhen në dosje që i përket vendimit nr.44, datë 20.09.2007, vetëm se ndryshon mendimi i trupës gjyquese për episodin e datës 17.03.2005, ku trupi i parë

gjykues mendon se deklarimi i vetëm i shtetasit Etem Danaj nuk mbështetet në prova të tjera ndërsa trupa e dyte pranon se mbështetet në prova të tjera dhe e konsideron fajtor të pandehurin Hasan.

- i Gjithashtu vendimi i mësipërm bie në kundërshtim me parimin e mos dënimit dy herë për të njëjtën veprë penale, kjo referuar nenit 4 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, protokollin 7, neni 34 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe neni 7 i K.Pr.Penale pasi rastet e përsëritura, pra faktet kriminale të trafikimit përbëjnë veprën penale atë të parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal.

Kundër vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ka ushtruar rekurs i gjykuari Laver Tozaj, nëpërmjet avokatit të tij, i cili kërkon prishjen e këtij vendimi dhe deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Laver Tozaj, duke parashtruar këto shkaqe:

- i Gjykata nuk ka marre parasysh kërkesat e mbrojtjes për pushimin e çështjes, duke mos argumentuar me prova të kundërtën e kësaj, por duke u bazuar vetëm në deklaratimet e një bashkë të pandehuri i cili rezulton se është dënuar nga gjykata për këtë veprë penale që kërkon të implikojë dhe të pandehurin Laver, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e nenit 156/b të K.Pr.Penale
- i Gjykata ka qenë e njëanshme në vlerësimin e provave, njëkohësisht i ka dhënë vlerë të paracaktuar thënieve të bashkëtpandehurit Et'hem Danaj dhe konsideron si provë faktin se nga numri i telefonit për të cilin është akuzuar i pandehuri Laver është telefonuar disa herë në numrin e telefonit fiks të shtëpisë së tij, duke arritur në konkluzionin absurd se ky i pandehur është autor i veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, pavarësisht se nga deshifrimi i këtyre bisedave nuk rezulton që të jetë biseduar apo të ketë lidhje me veprën penale.
- i I akuzuari Laver Tozaj nuk ka asnjë lidhje me veprimet e kryera për blerjen e kamionit dhe asnjë veprim tjetër të kundërligjshëm, por ai ka filluar trafikimin e lëndës narkotike pas episodit të datës 17.03.2005 dhe pikërisht në Dhjetor të vitit 2005, ku për këtë çështje është dënuar nga drejtësia.
- i Organi i akuzës nuk ka asnjë provë apo dëshmi tjetër për të vërtetuar se i pandehuri Laver Tozaj është bashkëpunëtor ose i implikuar në episodin për të cilin akuzohet nga Prokuroria për Krime të Rënda, në një kohë që jo vetëm që dëshmitaret Fatos Peqini dhe Islam Beshku nuk e kanë përmendur fare në deklaratimet e tyre (siç pranon padrejtësisht gjykata), por dhe sikur të merret e mirëqenë ngjarja ashtu siç pretendon organi i akuzës, një gjë është fare mirë e qartë se nuk mundet që ndonjë makinë të shkonte në qafën e Koshovicës (ku gjoja e ka pritur i pandehuri Laver, të pandehurin tjetër Et'hem Danaj) që të përshkonte atë rrugë për një orë, kur në të vërtetë duhen të paktën dy orë për të vajtur atje.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ka ushtruar rekurs i gjykuari Ardi Xhaferi, nëpërmjet avokatit të tij, i cili kërkon prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes, duke parashtruar këto shkaqe:

- i I dënuari Et'hem Danaj, në procesverbalin “Për deklarime nga personi ndaj të cilit zhvillon hetime” i datës 17.03.2005, nuk shprehet në asnjë moment për ndonjë shtetas të quajtur Ardi Xhaferi.
- i Në procesverbalin “Për këqyrjen e telefonit celular” të datës 17.03.2005 dhe konkretisht të telefonit “Nokia” me numër karte 0692805089 të të dënuarit Et'hem Danaj, saktësohet qartë se: “.....tek numri i telefonave të regjistruara tek telefonatat hyrëse e dalëse; tek telefonatat e humbura dhe tek sms e dala e të marra, tek ky numër i celularit të Et'hem Danaj, nuk figuron asnjë kontakt me numrin e telefonit të të pandehurit Ardi Xhaferi.

- i Në procesverbalin “Për këqyrjen e sendit” të datës 26.05.2006 dhe konkretisht të tre kartave numra celulari të të dënuarit Et'hem Danaj: Tek numrat e telefonave të regjistruar, tek telefonatat hyrëse e dalëse; tek telefonatat e humbura dhe tek sms e dala e të marra, nuk figuron asnjë kontakt me numrin e telefonit të të pandehurit Ardi Xhaferi.
- i Organi i akuzës, pas 4 vitesh (në mars të vitit 2009 ka filluar procedimi për Ardi Xhaferin), ka vazhduar të veprojë në shkelje të ligjit procedural penal, duke vazhduar të hapë procedime të tjera me të njëjtin numër procedimi (Nr.29), por me fraksione (29/1, 29/2, 29/4), kur hetimet për ngjarjen e datës 17.03.2005 ishin përfunduar në datën 18.04.2005, madje me vendim të formës së prere ishin deklaruar fajtorë të dënuarit Ethem Danaj dhe Alket Llanaj dhe sipas nenit 324 të K.Pr.Penale për hetimet komplekse kohëzgjatja e hetimeve nuk mund të zgjasë më shumë se dy vjet.
- i Sipas nenit 128 të K.Pr.Penale aktet procedurale në ngarkim të të pandehurit Ardi Xhaferi janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me pikën 2 të këtij neni dhe gjykata gabimisht ka vazhduar të shqyrtojë mbi akte absolutisht të pavlefshme dhe për gjatë dy vitesh në paraburgim të këtij të pandehuri është përpjekur të justifikojë “pavlefshmërinë e akteve të kryera jashtë afateve ligjore”, duke bërë interpretime për të njëjtat dispozita në kundërshtim dhe me sa ka arsyetuar në vendimin e saj.
- i Fajësia në kapërcim të shkeljeve të ligjit për shtetasin Ardi Xhaferi, sipas organit të akuzës dhe gjykatës qëndron në dëshminë e dhënë nga shtetasi Fatos Peqini me të cilin Ardi ka patur njohje prej 5-6 vitesh për shkak të ushtrimit të të njëjtit aktivitet të shitjes së makinave, por deklarimet e tij, megjithëse kontradiktore, nuk e ngarkojnë me përgjegjësi penale të pandehurin Ardi, por dhe fakti se kontrata e shitblerjes së trajlerit vërteton se shitës e blerësa janë persona të tjerë, mbi të cilët qëndrojnë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga kryerja e këtij veprimi juridik, për më tepër që dhe përgjimi ambiantal i kryer mes këtyre personave, ndonëse në shkelje të ligjit procedural penal nuk provon asnjë lidhje me veprën penale.
- i Gjykata e Lartë duhet të mbaje parasysh faktin se i pandehuri Ardi Xhaferi është në kushte shumë të vështira familjare dhe ekonomike, pasi bashkëshortja e tij është e papunë për shkak se fëmija i dytë (një vajzë 5 vjeçe) vuan nga sëmundja e pashërueshme “Daun” dhe kërkon kujdes të veçantë, për më tepër që për aktivitetin e tij privat, në vitin 2003, meqenëse i pandehuri krijoi Shoqërinë “AREN-2003”, ka marrë nga Banka Italo-Amerikane sot Intesa San Paolo një kredi prej 300 000 euro dhe ky aktivitet mund të shkojë drejt falimentimit për vetë pamundësitë e krijuara nga izolimi padrejtësisht i të pandehurit Ardi Xhaferi, që në shoqërinë e tij veç të tjerash mbante 13 punonjës të tjerë.

#### KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Tom Ndreca; prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit për të gjykuarin Helidon dhe lënien në fuqi të këtij vendimi për të gjykuarit e tjerë me ndryshim për mos zbatim të nenit 23 të K.Penal; av. M.Pëllumbi i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit; Av.Skënder Breca, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pushimin e çështjes; si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

#### V Ë R E N

Vendimi nr.05, datë 18.01.2011 t Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda Tiranë, është i bazuar në ligj, si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Nga aktet e administruara në dosje rezulton se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë 07.07.2009 ka paraqitur për gjykim para Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, procedimin penal nr.29/4, viti 2006, në ngarkim të të pandehurve Helidon Xhaferi, Ardi Xhaferi, Hasan Gjinaj e Xhafer ndryshe Laver Tozaj, të akuzuar se në bashkëpunim kanë kryer veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve", parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal, në këto rrethana:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.29, datë 18.03.2005, në ngarkim të shtetasit (të dënuar) Et'hem Danaj, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, pasi në datë 17.03.2005, në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë, është sekuestruar në mjetin e drejtuar prej tij sasia prej 1146 kg lëndë narkotike "cannabis sativa", e cila ishte destinuar për të kaluar në territorin e shtetit grek.

Në vazhdim të hetimeve për procedimin penal nr.29, është kryer regjistrimi i procedimit penal nr.29/1, viti 2005, pasi në datë 24.12.2005 në Himarë, Vlorë, është sekuestruar sasia 335,2 kg lëndë narkotike "cannabis sativa", e destinuar edhe kjo për t'u trafikuar në Greqi (nëpërmjet detit me skaf), për të cilën është kryer arrestimi i shtetasve Hasan Gjinaj, Laver ndryshe Xhafer Tozaj, Aranit Halilaj, Ilia (Irir) Gjicali dhe Artur Balilo.

Në përfundim të hetimeve të kryera në kuadër të procedimit penal nr.29, viti 2005, për episodin e datës 17.03.2005, çështja në ngarkim të të pandehurve Et'hem Danaj dhe Alket Llanaj është dërguar në gjyq, ku dhe janë deklaruar fajtorë dhe dënuar për veprën penale të "Trafikimit të narkotikeve", parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

Po ashtu edhe procedimi penal nr.29/1, viti 2005, në ngarkim të të pandehurve Hasan Gjinaj, Laver (Xhafer) Tozaj, Aranit Halilaj, Ilia (Irir) Gjicali dhe Artur Balilo për episodin e datës 24.12.2005 është dërguar për gjykim, në përfundim të të cilit këta shtetas janë deklaruar fajtorë dhe dënuar për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal, vendimi i cili ka marrë formë të prerë.

Hetimet paraprake në procedimin penal nr.29/2, i veçuar nga procedimi penal nr.29/1, kanë konsistuar në identifikimin dhe provimin e veprimtarisë kriminale të personave të tjerë bashkëpunëtorë, në episode kriminale të datave 17.03.2005 dhe 24.12.2005. Në vijim të hetimeve, procedimi penal në ngarkim të të pandehurve Helidon Xhaferi, Ardi Xhaferi, Hasan Gjinaj e Xhafer (Laver) Tozaj, është numërtuar me nr.29/4, i cili bën fjalë për ngjarjen e datës 17.03.2005, nga i cili ka rezultuar se:

Në këtë datë (17.03.2005), në Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë, forcat e policisë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin Et'hem Danaj, pasi në mjetin kamion tip Volvo, me targë TR 3054 E koka tërheqëse e tij dhe TR 9195 E rimorkio e këtij mjeti, në drejtim të të cilit ishte shtetasi Et'hem Danaj, dhe me të cilin po kryente procedurat për kalimin në Pikën e Kalimit Kufitar, Kakavijë, për të udhëtuar për në shtetin grek, në rimorkio, u gjet e fshehur sasia prej 1146 kg lëndë narkotike e llojit "cannabis sativa".

Në kuadër të këtij procedimi penal, me nr.29/4, për episodin e datës 17.03.2005, për të cilin janë dërguar për gjykim të pandehurit Helidon Xhaferi, Ardi Xhaferi, Hasan Gjinaj dhe Xhafer ndryshe Laver Tozaj, (krahas shtetasve Et'hem Danaj dhe Alket Llanaj, të cilët janë dënuar për këtë episod për kryerje të veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/1/2 i Kodit Penal), rezulton se nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprime hetimore, të cilat janë parashtruar në gjykim dhe janë cituar hollësisht dhe në vendimet respektive të gjykatave.

Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e ka gjetur të provuar akuzën në ngarkim të të pandehurve Ardi Xhaferi Hasan Gjinaj, Xhafer ndryshe Laver Tozaj, ndërsa për të pandehurin Helidon Xhaferi e ka gjetur të paprovuar akuzën në ngarkim të tij, duke vendosur me vendimin nr.26 datë 21.07.2010:

deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Helidon Xhaferi për kryerje të veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal, sepse nuk provohet kryerja prej tij e kësaj veprë penale, konform pikës “d” të nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale; deklarimin fajtorë të të pandehurve Ardi Xhaferi Hasan Gjinaj dhe Xhafer ndryshe Laver Tozaj për kryerjen e veprës penale të: “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal duke i dënuar përfundimisht, respektivisht, me 6 vjet e 8 muaj burgim, 7 vjet e 4 muaj burgim dhe 7 vjet e 4 muaj burgim.

Ky vendim është ankimuar si nga Prokurori (për pjesën që ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin Helidon Xhaferi) dhe nga të pandehurit Ardi Xhaferi Hasan Gjinaj, Xhafer ndryshe Laver Tozaj, të cilët kanë kërkuar pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre, lidhur me akuzën përkatëse.

Gjykata e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.05, datë 18.01.2011 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.26, datë 21.07.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për të pandehurin Helidon Xhaferi.

Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm për cilësimin ligjor, deklarimin fajtor të të pandehurve Ardi Xhaferi, Hasan Gjinaj dhe Xhafer (Laver) Tozaj, për kryerjen e veprës penale “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Ndryshimin e vendimit nr.26, datë 21.07.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë për të pandehurin Ardi Xhaferi për kryerjen e penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, ngelur në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtate) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Ardi Xhaferi me 4 vjet e 8 muaj burgim.

Në korigjim të gabimit material për të pandehurin Xhafer ndryshe Laver Zotaj, në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit Xhafer (Laver) Zotaj me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.”

Në këtë vendim, pasi ka analizuar hollësisht rrethanat e ngjarjes, pretendimet dhe prapësimet respektive të palëve ankuese, gjykata ka arsyetuar ndër të tjera: *...Duke u nisur nga të gjithë provat dhe rrethanat e faktit të trajtuara më lart, gjykata konkludon se me të drejtë të pandehurit Hasan Gjinaj, Xhafer ndryshe Laver Tozaj dhe i pandehuri Ardi Xhaferi me veprimet e tyre të kundërligjshme kanë kryer veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 283/a/2 të Kodit Penal dhe janë gjetur fajtorë, ...ka rezultuar e provuar se këta të pandehur në bashkëpunim me njëri tjetrin dhe me persona të tjerë kanë realizuar eksportimin e sasisë 1146 kg lëndë narkotike “cannabis sativa” për në shtetin grek, ku:- I pandehuri Hasan Gjinaj ka qenë në rolin e organizatorit (duke bërë të mundur gjetjen e personit Et’hem Danaj që do të transportonte lëndën narkotike dhe që është arrestuar në flagrance si dhe ka shkuar më parë në shtetin grek që të priste lëndën narkotike), ndërsa te pandehurit Hasan Gjinaj dhe Xhafer, ndryshe Laver Tozaj, kanë qenë në rolin e ndihmësit në kryerjen e veprës penale, e konkretisht i pandehuri Xhafer ndryshe Laver Tozaj ka ndjekur dhe shoqëruar të gjykuarin Et’hem Danaj gjatë kohës që ky kryente transportin e lëndës narkotike, ndërsa i pandehuri Ardi Xhaferi ka bërë të mundur heqjen e kokës tërheqëse me të cilën është tërhequr trajleri që ka transportuar atë...kjo veprë ka mbetur në fazën e tentativës (ashtu siç ka konkluduar gjykata e shkallës së parë në vendim), pasi eksportimi i saj për në shtetin grek nuk është realizuar plotësisht, për arsye të pavarura nga vullneti i të pandehurve (kapja në flagrancë në pikën kufitare), për këtë arsye pretendimet e prokurorisë lidhur me këtë moment gjenden të pabazuara dhe nuk*

*përbëjnë shkak për cenimin e vendimit...*

*Vlerësimet e bëra nga gjykata lidhur me elementet e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 të Kodit Penal, gjenden në harmoni me ligjin dhe në zbatim të drejtë të tij...*

*I drejtë është vendimi dhe për të pandehurin Helidon Xhaferi i cili gjendet i pafajshëm për kryerjen e kësaj veprë penale... ”.*

Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në pjesën ku është deklaruar i pafajshëm i pandehuri Helidon Xhaferi dhe të gjykuarit Hasan Gjinaj, Xhafer ndryshe Laver Tozaj dhe Ardi Xhaferi, (nëpërmjet përfaqësuesve ligjore) të cilët kërkojnë prishjen e vendimeve dhe pushimin e akuzës ndaj tyre, duke parashtruar shkaqet respektive, të cituara hollësisht në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi mori në shqyrtim shkaqet e rekurseve të paraqitura, rrethanat në tërësi të çështjes dhe argumentet e vendimeve gjyqësore, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda, nr.05, datë 18.01.2011 është marrë në zbatim të drejtë të ligjit, ndërsa rekursat e paraqitura nuk përmbajnë shkaqe nga ato që mund të bëjnë të cenueshëm vendimin objekt rekursi.

Nga shqyrtimi i akteve konstatohet se të gjithë pretendimet e parashtruara në rekursat e paraqitura para kësaj gjykate janë parashtruar në të njëjtën mënyrë dhe në ankimet e ushtruara nga ana e tyre përpara Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda, e cila u ka dhënë përgjigje në arsyetimin e vendimit.

I gjykuari Ardi Xhaferi pretendon se në kuptim të nenit 128 të K.Pr.Penale aktet procedurale në ngarkim të të pandehurit Ardi Xhaferi janë absolutisht të pavlefshme pasi nuk respektohen dispozitat që lidhen me pikën 2 të këtij neni dhe gjykata gabimisht ka vazhduar të shqyrtojë mbi akte absolutisht të pavlefshme se për të vërtetuar fajësinë e tij. Ky pretendim është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila, megjithëse ka konkluduar se nga ana e akuzës janë kryer shkelje procedurale në lidhje me shënimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e veprave penale, (neni 287/1 dhe 323/1 të Kodit të Procedurës Penale), në interpretim logjik dhe sistematik të përmbajtjes së dy dispozitave të mësipërme ka konkluduar me rrëzimin e kërkesës për pavlefshmërinë e akteve, duke u nisur nga fakti se në pikën 1 të nenit 323 të K.pr.P nuk parashikohet në mënyrë të shprehur se “*mosregjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e veprave penale, në momentin që prokurori merr dijeni për këtë emër sjell papërdorshmëri apo pavlefshmëri të veprimeve procedurale të kryera me tej*”.

Kolegji Penal e çmon të drejtë këtë pjesë të vendimit objekt rekursi, dhe përfundimet e gjykatës si të marra në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale penale .

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka zbatuar drejt ligjin penal përse i përket kualifikimit ligjor të veprimeve të kundraligjshme, penalisht të dënueshme të të gjykuarve Hasan Gjinaj, Xhafer ndryshe Laver Tozaj dhe Ardi Xhaferi për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 283/a/2 të Kodit Penal.

Nga gjykimi i kësaj çështje në të dy shkallët e gjykimit, në bazë të provave të shqyrtuara, është provuar plotësisht fakti penal dhe autorësia e të gjykuarve në veprimtarinë e kundraligjshme të trafikimit të një sasive lënde narkotike nga Shqipëria me destinacion Greqinë, për qëllime fitimi, e kryer në bashkëpunim mes tyre.

Neni 283/a “*Trafikimi i narkotikëve*” parashikon: “*Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*”



Ndryshe nga sa pretendohet në rekurset e paraqitura prej të gjykuarve, të cilët pretendojnë se gjykatat kanë vlerësuar në mënyrë të njëanshme provat duke kërkuar pafajësi lidhur me akuzën në ngarkim të tyre dhe pushimin e çështjes, ky kolegji i gjen të drejta përfundimet e gjykatës në vendim objekt rekursi, se fakti penal që iu atribuohet të pandehurve Ardi Xhaferi, Xhafer ndryshe Laver Tozaj dhe Hasan Gjinaj është provuar tërësisht pas analizës së provave në gjykim, ku si provë vendimtare, në unitet me tërësinë e provave të tjera, në përputhje me përcaktimet e nenit 193, pika 5 i K.Pr.Penale, është vlerësuar vendimi i formës së prerë nr.48, datë 12.11.2007 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me të cilin, për ngjarjen e datës 17.03.2005, është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurve Et'hem Danaj dhe Alket Llanaj, për veprën penale të "trafikimit të narkotikëve" në bashkëpunim të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit, ashtu si dhe ajo e Shkallës së Parë Për Krime të Rënda kanë analizuar hollësisht provat e paraqitura nga akuza dhe të pandehurit në gjykim, prapësimet respektive dhe kontradiktat mes tyre dhe në respektim të ligjit procedural penal, nenit 152 e vijues të K.Pr.Penale kanë konkluduar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, lidhur me fajësinë e të pandehurve Ardi Xhaferi, Xhafer ndryshe Laver Tozaj dhe Hasan Gjinaj për akuzën në ngarkim të tyre.

Kolegji Penal e gjen të pambështetur në ligj pretendimin e Prokurorit të Apelit të Krimeve të Rënda, lidhur me pjesën e vendimit që ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin Helidon Xhaferi, për akuzën në ngarkim të tij, duke e çmuar të drejtë konkluzionin e gjykatës " *se fajësia e të pandehurit Helidon Xhaferi në kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve*" në bashkëpunim të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, mbetet e dyshimtë dhe gjykata bazuar në nenin 4 të K.Pr.Penale, i cili përcakton se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit, e deklaron të pafajshëm këtë të pandehur për kryerjen e kësaj vepre penale...". Ky konkluzion i gjykatës është rrjedhojë e një analizë të hollësishme të provave në ngarkim të tij, në përputhje me përcaktimet procedurale penale.

I pambështetur çmohet dhe pretendimi i prokurorit në rekurs, lidhur me pjesën e vendimit i cili ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga neni 283/a/2 i Kodit Penal në 28/a/2, 22 të po këtij kodi (si vepër e mbetur në tentativë).

Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, nga tërësia e rrethanave të çështjes dhe akteve të administruara në gjykimet e zhvilluara ka rezultuar e provuar se, veprimtaria kriminale e të gjykuarve është ndërprerë dhe nuk ka përfunduar për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre (kapja në flagrancë nga forcat policore shqiptare në kufi e të pandehurit tjetër Et'hem Danaj) duke bërë që të mos realizohet qëllimi kriminal, për eksportimin e lëndës narkotike në shtetin Grek.

Për këto arsye, vendimi nr.05, datë 18.01.2011 i Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda, Tiranë është dhënë në zbatim të drejtë të ligjit material penal dhe procedural penal, si i tillë duhet të lihet në fuqi.

#### PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441/a të Kodit të Procedurës Penale,

#### V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr.05, datë 18.01.2011 të Gjykatës së Apelit Për Krime të Rënda Tiranë.

Tiranë, më 20.11.2013.